Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Enver Bytyçi	**22.12.2023**	**26.12.2023**	**2023/1021**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 15.12.2023, OE "BUSINESS PRO SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1021, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me diktuna te kembyesit te nxehtesis me kapacitet teknik 5000KW" me nr. të prokurimit: "NP Termoskos.sha-23-7147-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A..

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 85,000.00 €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/1021 i dt:15.12.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

LPP Neni, 1, 7,10,11,56,59,69

Rrgullorja 001/2022 per prokurim publik Neni 30.4, 30.5, 39.4, 39.8, 39.11, 40.3

Kodi i etikes profesionale

Deklarata nen betim e anetareve te komisionit

ANEKSI I KEKRESES PER RISHQYRTIM

HYRJE:

Me date 27.11.2023, AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK me te cilin njoftim AK ka anuluar kete aktivitet.

Ne perputhje me nenin 5 te LPP-se (kalkulimi I afateve kohore), dhe ne perputhje me nenin 108/A te LPP-se, kunder vendimit te AK, ne e parashtrojme kete kerkese per rishqyrtim.

AK, Ne kuader te kerkesave te veta te parashtruar ne dosjen e tenderit ne FDT ne piken 9.1 dhe 9.2 nder te tjera ka kerkua:

1. Operatori ekonomik duhet te ketë realizuara me sukses , kontrata në vlere 110,000.00 euro për furnizime te natyrës se ngjashme ne 3 vitet e fundit nga data e njoftimit per kontrate.

Si deshmi ka kerkuar:

1. Listën e kontratave që specifikon: furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmitë përcjella me certificate të livrimit-dorëzimit të mirë (kopje) ose referencë (kopje), per furnizime ,të nënshkruara nga pranuesi i furnizimeve për kontratat e cekura në listë.

Me date 27.11.2023, se bahku me njoftimin per anulim AK ka publikuar edhe letrat standarde per eliminim per te gjithe OE.

Arsyetimi I AK per eleiminim tone eshte:

ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar] *[Tenderi juaj është refuzuar]* për këto arsye :

Sipas komisionit të vlersimit të tenderve O.E."BUSINESS PRO"SH.P.K.nuk ka plotësuar kriteren e specifikimit të kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë;mungojne referencat e natyres së ngjajshme, për arsyje të cekura më lartë oferta juaj është e papërgjegjëshme.

Menjehre pas publikimit te ketij njoftimi ne perputhje me nenin 10 dhe 11 te LPP_se ne kemi kerkuar qasje ne dokumentacionin e ketij aktiviteti te prokurimit.

Me kete qasje ne kemi kerkuar kete dokumetnacion:

1. Vendimin per formimin e komisonit te vleresimit
2. Raportin e komisionit per vleresimin e tednereve
3. Dokumentacionin e ofertve te OE
4. Letrat standrde te AK me kerkese per sqarim te tederit te OE te cilet kane marre pjese ne kete aktiviet te prokurimit

5. Procesverbalin e mbajtejs se takimve te anetreve te komisionit se si kane ardhur deri te ky vleresim, cilat kane qene kriterete ne baze te se cilave keta anetare kane bere vleresimin e ofertave te OE pjesemarres.
6. Komunikimet ne mes te anetreve te komisionit dhe zyrtarit pergjegjes te prokurimit, ne lidhje me sqarimet shtese te kerkuara nga AK si dhe si eshte bere vleresimi I ofertave.
7. Si dhe cdo document tjeter qe kate beje me kete aktivitet dhe eshte ne perputhje me dispozitat e lartcekura.

Ne kete qasje neve nuk na eshte dhene qasje e pakufizuar ashtu siq eshte e parapare me nenin 10 dhe 11 te LPP-se.
Nuk na eshte dhene procesverbali I mbajtjes se takimeve te anetreve te komisionit ne menyre qe te dihet se si eshte bere vleresimi per secilin OE dhe si kane ardhur ne perfundim se referncat te cilat ne I kemi prezentuar nuk jane ne perputhje me kerkesat e AK. Ne cilin nen apo dispozite te LPP-se apo Regullores se prokurimit publik eshte bazuar komisoni qe ka ardhur deri te ky konstatim.
Ne pyetjen e perfaqesuesit tone I cili ka shkuar qe te terheq dokumetnacionin e kerkuar, se si kane ardhur deri te ky perfundim, Zyrtari Pergjegjes I Prokurimit, Z. Skender Maqastena ka thene se ai dhe komisionin kane qene ne KRPP ne menyre qe te konsultohen ne lidhje me kerkesen e tyre per refernca, mirepo ne KRPP nuk i eshte pergjgijgjur ne menyre konkrete.
Zyrtaret e KRPP-se I jane pergjigjur vetem se ju si AK e dini se cka keni kerkuar dhe eshte ligji I cili edhe e interpreton kerkesen per referenca, keshut qe ju duhet te bazoheni ne dispoziata e LPP-se, per refernca.
Prezent gjate kesaj bisede perveq Zyrtarit Pergjegjejs te Prokurimit, Z. Skender Maqastena dhe perfaqesuesit ton,Z. Musa Demaj ka qenë edhe zyrtari tjeter I prokurimit Z. Astrit Shyti.
Kjo pergjigje nga ana e zyrtareve te KRPP, ka bere me dije AK se keta duhet te bazohen ne kerkesat e parashtruara si dhe ne dispoziatat e LPP-se ne lidhje me kerkesat e parashtruara.
Se AK ka vepruar ne kundershtim me vet kerkesat e veta e po aashtu edhe ne kundershtim me te gjitha dispozitat e LPP-se, tregon edhe fakti ne zvarritje te marrjes se vendimit perfundimtar per kete aktivitiet.
Dihet fakti se ky aktivitet nuk eshte I ndonje natyre komplekse qe vleresimi te zgjate me shume se 60 dite nga dita e hapjes se tenderit, ndersa ne rastin konkret, ky vlresim ka zgjat 58 dite nga dita e hapjes se tenderit.
Me kete veprim AK ka bere shkelje te nenit:
40.3 te Rregullores 001/2022 per prokurim public ku sipas ketij neni:

Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. **Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve**.
Eshte shume mire e ditur se ky aktivitet nuk eshte I ndonje natyre komplekse qe te zgjaze per 58 dite.

Po ashtu eshte shume e rendesishme te ceket se Zyrtari Pergjegjes I Prokurimit, Z. Skender Maqastena nuk ka bere kerkese me kohe tek OE per vazhdimin e validitetit te ofertaves dhe vazhdimin e sigurimit te tenderit. Kerkesen per vazhdim te validitetit te ofertave e ka bere me date 29.11.2023 e qe eshte ne kundershtim me nenin:

30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit

të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. **Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)**
30.5 **Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre.**

Zyrtari Pergjgejgjes I prokurimit e ka derguar kerkesen per azhdim te validitetit te ofertes vetem pas qe ne me date 29.11.2023 kemi derguar nje email me te cilin ne kemi konfirmuar vazhdimin e validitetit te ofertes tone si dhe kemi derguar vazhdimin e sigurimit te tenderit.
Paraprakisht me dy shkresa (emaila) ne I kemi rikujtuar Zyrtarit pergjegjes te prokurimit se ne perputhje me dispozitat e LPP-se ky duhet te kerkoj nga OE vazhdimin e validitetit te ofertes dhe sigurimin e tenderit. Mirepo Ky zyrtar nuk I ka marre parasysh keto shkresa dhe I ka injoruar dhe kerkesen per vazhdim te validitetit e ka derguar me date 29.11.2023 ne ora 15:32 (qe eshte derguar pasi qe ne kemi derguar konfirmiminper vazhdim te validitetit te ofertes)
Bashkangjitur jane shkresat (emailat) te cilat ne I kemi derguar tek Zyrtri pergjegjes I prokurimit)

PRANDAJ, Duke pasur parasysh keto rrethana se si eshte bere vleresimi I ketij aktiviteti te prokurimit, Ne konsiderojm se vendimi I AK jo vetm se eshte I pa bazuar, jo professional por eshte edhe tendencioz me prapavije dhe qellime te caktuara per persona te caktuar.

Kur e themi kete e kemi parasysh faktin ze zvarritjen e pa arsyshme te AK ne perfundimin e vleresimit si dhe ne fund anulimin e pa bazuar ne dispozitat e LPP-se.

PERSHKRIMI I RASTIT:

Ashtu siq edhe e kemi cekur me larte me date 27.11.2023 AK ka anuluar kete aktivitet te prokurimit dhe po ashtu ka derguar letrat standard per eleiminim ku arsyetimi I AK per eliminimin tone eshte:

ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar] *[Tenderi juaj është refuzuar]* për këto arsye :

Sipas komisionit të vlersimit të tenderve O.E."BUSINESS PRO"SH.P.K.nuk ka plotësuar kriteren e specifikimit të kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë;mungojne referencat e natyres së ngjajshme, për arsyje të cekura më lartë oferta juaj është e papërgjegjëshme.

Ky arsyetim I AK per eleiminimn tone per shkak se kinse ne nuk I kemi ofruar referncat ne perputhje me kerkesat e AK ne dosjen e tenderit, eshte ne kundershtim te plote me nenin 1, 7, 56, 59,dhe 69 te LPP-se dhe me vete kerkesen e AK, sepse ne kemi ofruar listen e referncave si dhe referencat ne perputhje te plote me kerkesen e AK dhe ne perputhje te plote me ne nin 69 te LPP-se, dhe vendimi I AK jo vetem se eshte ne kundershtim me dispozitat e LPP-se dhe Rregullores 001/2022 per prokurim publik, por eshte vendim **JO PROFESIONAL, ABSURD dhe SKANDALOZ**.

Kur e themi kete kemi parasysh faktin se:

Me date 26.10.2023, Ka derguar nje leter standarde per sqarim te tenderit tone me kete pyetje:

Shkeputur nga letra standarde per sqarim te tednerit:

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Sipas komisionit te vlersimit te ofertave kerkes ne dojse te tenderit ka qene te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 - Operatori ekonomik duhet te ketë realizuara me sukses , kontrata në vlere 110,000.00 euro për furnizime te **natyrës se ngjashme** ne 3 vitet e fundit nga data e njoftimit per kontrate Ndersa ne oferten tuaj keni bashkangjitur listen e kontratave te realizuara si ne vijim :

BusinessPro

KONTRATAT DHE LISTA E REFERENCAVE PER FURNIZIME

2019-2023

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emri I Kontratës	Nr Kontratës	Vlera e kontratës	Data
1	"Trepca" Ndërmarje ne administrim te AKP-se	Furnizim me material për mirëmbajtjen e mullirit me afera në Flotacioninin në Kishnicë	102	43,869.00	11.01.2019
2	"Trepca" Sh.a	Furnizim me pompa dhe material per linja te ujit ne miniere	001/2019	8,884.16	18.03.2019
3	Korporata Energjetike e Kosovës	Furnizim me dibtanga Gome	2230	5,531.25	10.04.2019
4	"Trepca" Sh.a	Furnizim me shirita gome	KIIA 045/2019	13,977.35	10.06.2019
5	"Termokos"sha	Furnizim me Gypa, Lidhese, dhe Kthesa te paruzoluara	1480/2019	46,527,68	18.12.2019
6	Korporata Energjetike e Kosovës	Demontimi, furnizimi dhe montimi I pjesve rezerve per elektrofiltr	1494/2020	204,979,70	27.02.2020
7	Korporata Energjetike e Kosovës	Furnizim me goma teknike dhe unazore	8565/2020	17,578.40	28.09.2020
8	Termokos Sha	Furnizim me valvola dhe Filtera	713/2020	23.665,74	28.04.2020
9	Termokos sha	Furnizim me pompa qarkullimi	1052/2020	32,047.82	06.08.2020
10	Korporata Energjetike e Kosovës	Furnizimi me pompe pistonike te presionit te larte levizese	10882/20	129,799.45	11.12.2020
11	Termokos sha	Furnizim me gypa, lidhese dhe kthesa te paruzoluara	256/21	51,999.08	02.03.2021
12	Termokos sha	Furnizim me gypa, lidhese dhe kthesa te paruzoluara	1060/2021	28,991.75	16.06.2021
13	Korporata Energjetike e Kosovës	Liferimi i pompave per sistemin e ngrohjes ne TC Kosova B	7245/21	15,675.59	30.09.2021
14	Termokos sha	Furnizim me pompa qarkullimi	1622/21	17,849.12	03.12.2021
15	Korporata Energjetike e Kosovës	Furnizim me onaza gome dhe distanues per rule	1379/2022	12,968.20	10.03.2022
16	Korporata Energjetike e Kosovës	Furnizim me goma teknike për xhunta dhe paurtuese te shiritave	2954/2022	14,705.40	16.05.2022
17	Korporata Energjetike e Kosovës	Furnizim me cement zjarrdurues	3715/2022	8,999.23	15.06.2022
18.	Termokos sha	Furnizim me diktuna te kembyesve ne stacionin HKS	1847/2022	64,596.10	08.11.2022

19	Termokos sha	Furnizim me grym, [illegible] per [illegible]	2042/2022	47,339.37	02.12.2022
20	Korporata Energetike e Kosovës	Furnizim me ngjisë dhe gomë te fleksit per vulkanizim si rezervë	2369/2023	8,730.35	14.04.2023
21	Kompania e Ujësjellësit Rajonal "Prishtina"	Furnizim me valvola bllokuese-bllokada per shkyçje	1450/2023	838.00	26.04.2023
22	K.R.U Mitrovica SHA	Furnizim me bllokues te valvulave	051-705	999.46	05.05.2023
23	Kompania e Ujësjellësit Rajonal "Prishtina"	Furnizim me valvola bllokuese-bllokada per shkyçje	2731/2023	6,192.00	27.07.2023

29.09.2023

Ju lutemi te na sqaroni ne detaje , se qfare materiali keni furnizuar per pozicionin 7 ,15,16,20 ne listen e projekteve te prezantuara ne oferten tuaj .

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh **me shkrim** në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues ose në numrin e faks-it *[shëno numrin e faks-it]* apo në e-mailit *[skender.maqastena@termokos.org]* brenda *5* **ditëve** nga data e kësaj kërkese.

Ne perputhje me kerkesen e AK dhe ne perputhje me afatin e dhene per pergjigje, Me date 30.10.2023, ne jemi pergjigjur kerkeses se AK per sqarim te tenderit dhe me pergjigje kemi dhene sqarime per secilen reference veq e veq.

Pergjigjen te cilen ne e kemi derguar a deshmon se vendimi I AK eshte ne kundershtim te plote me nenin 69 te LPP-se dhe njeheresh paraqet shkelje flagrante jo vetem te ketij neni por edhe shkelje te rende te dispozitave tjera te LPP-se dhe legjislacionit sekondar.

(Shih me posht pergjigejn te cilen e kemi derguar me date 30.10.2023 dhe deshmit te cilat tregojn shkeljet ligjore te AK).

Edhe pse pergjgijen te cilen ne e kemi derguar qysh me date 30.10.2023, AK vendimin perfundimtare e ka publikuar me date 27.11.2023.

Pergjigja te cilen e kemi derguar tek AK ne kerkesen per sqarim te tenderi tone, e qe njeherit paraqet edhe kerkesen tone per shyrtim eshte:

Ne perputhje me nenin 69 te LPP-se, **Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale pragrafi 2 I ketij neni:**

2. Gjatë udhëheqjes së procedurave që shpien drejt dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet livrimin i produkteve, nga operatorët ekonomik mund të kërkohet që të dëshmojnë aftësinë e tyre teknike përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të produkteve që duhet të furnizohen:
të **listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën**

dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti

dhe

Ne perputhje me opinionin e dhene nga KRPP me date 09.06.2023 per nenin 69 te LPP-se, paragrafi 2
Referuju web faqes se KRPP-se
11. 09.06.2023 Cili është përkufizimi i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme" në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit?

Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme", megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë:

OPINION
Termi "njëjtë (i, e)" mbiemër që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj.
Termi "ngjashëm (i, e)" mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme.
Në kuptim të prokurimit publik:

Termi " njëjtë (i, e)" ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a pune të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës.

Termi "të ngjashme" ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Shembull: Lënda e Kontratës "Furnizim me mollë". Nëse AK kërkon si dëshmi " Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro". Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatoret ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së).
Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përshkruhet si në vijim: "Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara....." Pra, nuk përmendet asnjëri nga termet "të njëjta" apo "të ngjashme".
Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t'i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet

<u>të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para.</u>

Dhe

Ne perputhje me pergjigejn te cilen KRPP e ka dhene me date 22.11.2022 e cila pergjigej eshte ne web faqen e e prokurimit publike.

10. 22.11.2022 Kurdo që kërkohet në FDT të Dosjes së Tenderit dhe në Njoftim për Kontratë "Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë", gjatë vlerësimit të tenderëve, a duhet të merret për bazë totali i vlerës së kontratës apo duhet të përpjesëtohet?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim:
Sa i përket dëshmive të kërkuara nga Autoritetet kontraktuese në FTD të Dosjes së tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në lidhje me Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, paragrafi 4.2 i nenit 69 të këtij ligji përcakton: 4.2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira,shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja ecertifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënënshkrura nga autoriteti i tillë publik: (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë; Në kuptim të nën-paragrafit 4.2 të nenit 69 të lart cituar, AK në rast se kërkon dëshminë - Listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, (nga data e njoftimit për kontratë) kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë. Pra për bazë duhet të merret periudha e përfundimit jo e fillimit të kontratës. Për më shumë, kjo do të thotë se në këtë listë duhet të saktësohen të gjitha informatat e hijezuara në këtë nën-paragraf: Llojin e shërbimeve, shumën e kontratës që nënkupton totalin e përgjithshëm të kontratës, datën dhe pranuesin. Si rrjedhojë, gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve në përputhje me dispozitën e lart cituar duhet të merret për bazë shuma totale e kontratës së specifikuar në listë dhe jo të përpjesëtohet. Shembull: Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën 3.000.000 euro kontrata kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Dëshmia dokumentare 1: Lista e kontratave kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Në rast se kërkesa e kontratave të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë i referohet së bashku një totali prej 3,000,000 euro në tri vitet e fundit dhe operatori ekonomik ka realizuar (përfunduar) një kontratë tri vjeçare t në vlerë prej 3,000,000 euro (kontrata e cila ka filluar dy vite më herët), konsiderohet se OE ka përmbushur kërkesën minimale vetëm me atë kontratë. Kushti minimal është përmbushur duke prezantuar dëshminë Listën e kontratave

të realizuara së bashku në total prej 3,000,000 euro në tri vite dhe nuk ka rëndësi se kontrata ka filluar dy vite më herët.

Keshtu qe:

Ne peruthje me nenin 69, paragrafi 2, ne perputhje me opinionin e KRPP-se te leshuar me date 11.06.2023 ne platformen e prokurimit public, me numer rendor 11 te opinionit TE KPPP-se dhe ne perputhje me pergjigjen e KRPP-se te dates 22.10.2022, ne I kemi plotesuar kerkesat e juaja per refernca qe nga numri rendor 6 deri 23, referenca keto te paraqitura ne listen e referncave tona te cilen e kemi dorezuar se bashku dokumentacionin perkrahes (referncat per furnizime) apo vetem me kontraten ne numrin rendor 6, ne e kemi plotesuar kerkesen e juaj per refernca, sepse vlera e kesaj kontrate me nr. Rendor 6 ne listen e referncave eshte me e larte se sa kerkesa e juaj.

Arsyeja pse ne I kemi hijezuar disa refenca ne listen tone te referncave dhe jo te gjitha, eshte se ju keni kerkuar refernca te ngjajshme me produkin e kerkuar ne dosjen e tenderit.
Produkti I kerkuar nga ju eshte produkt I prodhuar nga materiali I gomes, dhe referncat e hijezuar kane te bejne me produkte te prodhuara nga materiali I gomes.
Me kerksen e juaj per sqarime detale te refencacave te hijezuar ne listen e referncave tona per furnizime kemi dhene sqarime shtese te detajuara per secilen refernce veç e veç.

1. Refernca me numer rendor 7 ne listen e referncave

AK eshte Korporata Energjetike e Kosoves, Titulli I kontrates **"FURNIZIM ME GOMA TEKNIKE DHE ANESORE TE GOMES", numri I prokurimit KEK-20-3363-121, data e nenshkrimit te kontrates 28.09.2020, data e realizimit te kontrates 23.11.2020, shuma e kontrates eshte 17,578.40 Euro.**
Ne lidhje me kete reference, bashkangjitur e keni specifikimin teknik te kerkuar ne dosjen e tenderit kontraten e nenshkruar si dhe specifikimet teknike te ofruara nga ne, ne baze te se ciles oferte eshte nenshkruar kontrata.
Nga sa shihet, kjo ka kontrate ka te beje me produkte te ndryshme nga materiali I gomes_goma tenike dhe anesore te gomes.

2. Refernca me numer rendor 15 ne listen e referncave.

AK eshte Korporata Energjetike e Kosoves, Titulli I kontrates eshte **"Furnizim me unaza gome dhe distatues per rule"numri I prokurimi - KEK-21-6442-1-2-1,** data e nenshkrimit te kontrates 10.03.2022, data e realizimit te kontrates 05.04.2022, shuma e kontrates 12,968.20 Euro,
Ne lidhje me kete refernce, bashkangjitur e keni specifikimin teknik te kerkuara me dosje te tenderit, kontraten e nenshkruar si dhe specifikimin teknike te ofruar ne baze te se cilit specifikim eshte nenshkruar kontrata.
Kjo kontrate ka te beje me furnizimin e produkteve te prodhuara nga materiali I gomes-unaza gome dhe distancues per rule.

3. Referenca me numer rendor 16 ne listen e referncave.

AK eshte Korporata Energjetike e Kosoves, Titulli I kontrates **"Furnizim me goma teknike për xhunta dhe pastruese të shiritave ", numri I prokurimit KEK-22-1478-1-2-1,** data e nenshkrimit te kontrates 16.05.2022, data e realizimit te kontrates 15.06.2022, shuma e kontrates eshte 14,705.40 Euro
Ne lidhje me kete reference, bashkangjitur e keni specifikimin teknik te kerkuar ne dosjen e tenderit kontraten e nenshkruar si dhe specifikimet teknike te ofruara nga ne, ne baze te se ciles oferte eshte nenshkruar kontrata.

Nga sa shihet, kjo ka kontrate ka te beje me produkte te ndryshme nga materiali I gomes, goma teknike per xhunta dhe pastrues per shirita transportues.

4. Referenca me nr rendor 18.

AK eshte Termokos sha, Titulli I kontrates **"Furnizim me diktuna te kembyeseve ne stacionin HRS ", numri I prokurimit** TER -22- 012-1.2.
Per sa I perket kesaj kontrate, duke pasur parasysh faktin se kjo kontrate eshte e nenshkruar me ju si AK, besojm se nuk kemi nevoje per sqarime te tjera sepse behet fjale per produktin e njejte/identik , dihtuna nga materiali I gomes, qe eshte kerkese e njejte edhe tani.
Shuma totale e kesaj kontrate eshte 64,596.10.

5. Referenca me numer rendor 20.

AK eshte Korporata Energjetike e Kosoves, Titulli I kontrates **"Furnizim me ngjitës dhe gomë te freskët për vullkanizim të nxehtë ", numri I prokurimit KEK-23-546-1-2-1,** data e nenshkrimit te kontrates 14.04.2023, data e realizimit te kontrates 18.05.2023, shuma e kontrates eshte 8,730.35 Euro.

Ne lidhje me kete reference, bashkangjitur e keni specifikimin teknik te kerkuara ne dosjen e tenderit kontraten e nenshkruar si dhe specifikimet teknike te ofruara nga ne, ne baze te se ciles oferte eshte nenshkruar kontrata.
Nga sa shihet, kjo kontrate ka te beje me produkte te ndryshme nga materiali I gomes -Furnizim me ngjites per gome dhe gome e fresket (raw rubber) per vullkanizim te nxehte.

Nga sa shihet ne sqarimet e detalizuar per secilen reference vec e vec, te gjtha keto kontrata kane te bejne me produket te prodhuara nga material i gomes dhe jane te ngjajshme me kerkesen e juaj ku jane kerkuar diktuna te prodhuara nga materiali I gomes.

Vlera e sakte e te gjitha kontratave nga produktet e gomes eshte:

17,578.40 + 12,968.20 +14,705.40 + 64,596.10 + 8,730.35 = 118,578.45 Euro e qe e tejkalon vleren te cilen ju e keni kerkuar e qe eshte110,000.00Euro.

Ne realitet duke marr parasysh nenin 69, paragrafin 2, opinionin e KRPP dhe pergjigejn e KRPP-se, ne lidhje me kerkesen e juaj, shuma totale e kontratave tona te realizuar ne periudhne ne tri vitet e fundit eshte shume me e larte se sa qe ju e keni kerkuar, sespse ashtu siq edhe eshte sqaruar me larte, te gjitha kontratat per furnizime qe jane realizuar ne tri vitet e fundit nga dita e publikimit te njoftimit per kontrate, ne perputhje me nenin 69 te LPP-se jane te pranueshme si refernce per kontratat per furnizime,

Shuma totale e te gjitha kontratave tona per furnizime ne tri vitet e fundit nga dita e njoftimit per kontrate eshte: 453,117.52.

Ne perputhje me nenin 69 te LPP-se, Vetem kontrata me nr. Rendor 6 ne listen tone te referncave e tejkalon shume e kerkuar nga ana e juaj, dhe referncen per kete projekt, po ashtu e kemi bashkangjitur ne dokumentacionin e dosjes tone te tenderit.

6	Korporata Energjetike e Kosoves	Demontimi, **furnizimi** dhe montimi I pjesve rezrve per elektrolizer	Nr. I kontraes 1494/2020	Shuma e kontrates 204,979,70

Te gjitha referencat jane te verifikueshme dhe ju mund ti vertetoni ne cdo kohe.
Bashkangjitur jane sqarimet per secilen refernce te cilen ju e keni kerkuar.

Vlene te theksohet se per te gjitha referencat te cilat jane te hijezuara, e qe kane te bejne me produkte te ndryshme nga materiali I gomes, jane pjese rezerve te pajisjeve te ndryshme (jane llojet te diktunave nga materiali I ggomes te formave te ndryshme te cilat AK te ndryshme I quajne me emertime te ndryshme) pa te cilat pjese, pajisjet nuk mund te funksionojn, njejte skurse qe diktunat e kerkuar nga AK jane pjese rezerve e kembyesve te nxetesis, pa te ciliet kembyesit nuk funsionojn.

NUK e dijm se si AK ka ardhur ne perfundim se referncat per produkete nga materiali I gomes nuk jane refernca te ngjashme, ne baze te cilit kriter apo parim kane ardhur deri te ky perfundim.

Per secilen refence per te cilen AK ka kerkuar sqarime, ne kemi derguar edhe specifikimin teknik ku pershkruhet produkti dhe material I produktit qe kerkohet dhe per qfare qellimi kerkohet e qe te gjitha jane produkte nga materiali I gomes.

Ngasa shihet ne sqarimet e dhena, ne kemi ofruar te gjitha deshmit se ne kemi prezentuar listen e referncave dhe referncat qe jane ne perputhje te plote me kerkesen e AK.

Prandaj, Vendimi I AK per eliminimin tone eshte ne kundershtim te plote me nenin 1, 7 ,56, 59, dhe 69 sepse vleresimi, krahasimi dhe ekzaminimi eshte bere ne kundershtim me kerkesat e AK dhe paraqe shkelje edhe te nenit 56 te LPP-se sepse eleiminimi eshte bere per nje kerkese e cila nuk ka qene e parashtruar ne dosjen e tenderit.

Sepse:

Ne baze te arsyetimit te AK shihet se AK na ka eliminuar se ne nuk kemi ofruar refernca "identike" dhe per refencen e vet, Furnizim me diktuan per stacionin e HRS e ka cilesuar si refence te ngjashme Kjo nuk ka qene kerkese e AK, kerkesa e AK ka qene per refernca te "ngjajsme" (edhe sipas pergjgiejs se KRPP-se dhe opinion te dhene nga KRPP, AK nuk kate drejte qe te beje kerkese per refernca te njejta apo te ngjajshme, por kerkes duhet te behet ne perputhje me nenin 69 te LPP-se- REFERNCA PER FURNIZIME

Sipas Nenit 56 paragrafi 3

Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ne baze te ketij vendimi, shihet se AK na ka eleiminur se ne nuk kemi derguar refernca te njejta /identike me artikullin te cilin e kane kerkuar ne kete dosje te tenderit . Ne kete dosje te tenderit jane kerkuar diktuna nga materiali gomes. Si referenca ne kemi derguar kontrata te ndryshme te furnizimit me artkuj te prodhuar nga materiali I gomes e qe per AK, keto refernaca nuk jane refernca te ngjajshme, e qe paraqet **absurditet te llojit te vet**, sepse sipas nenit 69 te LPP-se, gjitha referncat per furnizime te cilat kane perfunduar me sukses ne tri vitet e fundit jane te pranueshme dhe nuk ka ndarje se a duhet te jene ato refernca te njejta/identike apo te ngjajshme apo te ndryshme.

Ne anen tjeter, ne perputhje me kerkesen e AK per refernca te ngjashme kemi derguar refernca ne perputhje te plote me kerkesen e AK, sepse referncat e hijezuara jane te ngjashme me kerkesen e AK dhe jane produkete te prodhuara nga materiali I gomes dhe qellimi dhe funksioni I ketyre produketeve eshte I njejte me kerkesen e AK.

Siq shihet nga raporti I komisionit, ne jemi eliminur se nuk kemi ofruar refernca identke me produketin te cilin AK e ka kerkuar, ku vetem refernca Furnizim me diktuna gome te cilen ne e kemi nga ky AK eshte e pranueshme sepse sipas mendimit te komisionit te vleresimit kjo refernce eshte e ngjajshme, Ne realitet kjo reference eshte identike me kerkesen e AK ne vitin 2022 sepse eshte aktiviteti I njejte ku kerkohen diktuna gome per kembyesit e nxehtesise te tipit: **SDN352-IS25-542-TMTL66-LIQUID**

Ne te dy dosjet e tenderit (2022 dhe 2023) kerkohen diktuna per kembyesit e nxehtesise per tipin SDN352-IS25-542-TMTL66-LIQUID, ku specifikimi teknik eshte identik me ate ne dosjen e kaluar. Ndryshimi I vetem eshte sasia e kerkuar. Nuk ka asnje ndryshim tjeter. E AK kete refernce tonen AK e llogarit si te ngjashme e qe ne realitet eshte identike

Ndersa referncat tjera nuk jane te pranueshme edhe pse keto refernca jane per produket te prodhuara nga materiali I gomes dhe jane te ngjajshme me produketin e kerkuar sepse jane produkete nga materiali I gomes dhe qellimi dhe funksioni dhe matrilai I gomes eshte I njetje.

Kjo nenkupton se AK paska kerkuar refernca identike e qe sipas nent 7 te LPP-se eshte rreptesisht e ndaluar, sepse eshte kriter diskriminues.(***Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatoret ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së).***

Mund te kuptohet se anetaret e komisionit te cilet jane nga njesia kerkuese, mund edhe te mos I dijne dispozitat e LPP-se apo edhe Regullat e prokurimit public sepse nuk jane te lidhur direct me dispoziatat dhe rregullat e LPP-se (edhe pse ata kane nenshkruar nje deklarate nen betim me te cilen deklarate jane betuar se vleresimin, krahasimin dhe ekzaminin e tendereve do ta bejne ne perputhje te plote me dispozitat e LPP-se), mirepo eshte befasuese se si Zyrtari Pergjegejes I Prokurimit Z.Skender Maqastena, ka lejuar qe te behet nje shkelje e tille dhe nuk e ka udhezuar komisionin se si duhet te respektohen kerkesat e parashtruara ne dosjen e tenderit e po ashtu edhe dispozitat e LPP-se. Me kete rast Zyrtari Pergjgejgejs I Prokurimit ka vepruar ne kundershtim me nenin 39 te Rregullores 001/2022 te Prokurimit Publik.

39.4 Zyrtari përgjegjës i Prokurimit nuk do të shërbej si anëtarë i komisionit vlerësues. Anëtarët e stafit të Departamentit të Prokurimit mund të shërbejnë si anëtarë të komisionit vlerësues. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do të organizoj punën e komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP.

39.8 Votimi vlen vetëm për kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Dosje të Tenderit.

39.11 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo te refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Ne situata të tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të nxjerr vendimin përfundimtar ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim.

Zyrtari Pergjegjes I prokurimit ka qene plotesisht I vetedijshem se kur e ka nenshkruar raportin e komisionit te vleresimit, vendimin per anulimin e tenderit si dhe letren standarde per eliminim tone **, ka bere shkelje flagrante dhe te qellimshme te dispozitave te LPP-se duke filluar naga neni1 I LPP-se, duke mos reaguar ne vleresimin jo te drejte te komisionit dhe duke u bere pjese e komisionit dhe merr vendime ne kundershtim me nenin 39.4 te Rregullores se prokurimit public.**

Eshte nje pyetje qe zyrtari pergjegjes I prokurimit duhet te pergjigjet

SI ESHTE E MUNDUR QE PER NJETJIN AKTIVITET TE PROKURIMIT I CILI KA QENE VITIN E KALUAR (2022) PER TE CILIN NE JEMI SHPERBLYER ME KONTRATE, REFERNCAT TE CILAT NE KEMI PREZENTUAR NE KETE AKTIVIET TE PROKURIMIT JANE TE NJEJTA (MUNGON VETEM REFERNCA PER FURNIZIM ME DIKTUNA GOME PER KONTRATEN TE CILEN JEMI SHPERBLYER NE VITIN 2022) , NE NUK JEMI ELEIMINUAR, DHE NE LISTEN E REFERNCAVE TE CILEN NE E KEMI PREZENTUAR NUK KEMI PASUR ASNJE REFERNCE PER FURNIZIM ME DIKTUNA GOME PER KEMBYES TE NXEHTESIS DHE JEMI SHPEBLYER ME KONTRATE. KEMI PREZENTUAR REFERNCA TE NDRYSHME ME PRODUKTE NGA MATERIALI I GOMES E TANI REFERNCAT E NJEJTA TE PREZENTUARA NE VITIN 2022, NE VITIN 2023 JANE TE PAPRANUESHME.

APO

SI ESHTE E MUNDUR QE PER NJE AKTIVITET TJETER PER DIKTUNA GOME I CILI KA QENE I PUBLIKUAR NE VITIN 2023 KU NE KEMI MARRE PJESE DHE KEMI PREZENTUAR TE NJEJTAT REFERENCA SIKURSE NE KETE AKTIVTET TE PROKURIMIT, DHE NUK JEMI ELIMINUAR PER REFERNCA.

TANI ME TE NJEJTAT REFERNCA ELIMINOHEMI PER KINSE NUK KEMI OFRUAR REFERNCA TE NJEJTA E QE KERKESA KA QENE PER REFERCA TE NGJAJSHME.

SHIH KERKESN E AK NE TE DY DOSJET PARAPRAKE PER REFERNCA DHE DO TE SHIHNI SE KERKESA PER REFERENCA ESHTE IDENTIKE ME KETE AKTIVITET TE PROKURIMIT DHE NE NUK JEMI ELIMINUAR, PERKUNDRAZI ME KETO REFERNCA NE JEMI SHPERBLYER ME KONTRATE NE VITIN 2022.

Kerkesa e AK ne vitin 2022 per diktuan gome per kembyes te nxehtes per aktivitetin e prokurimit:

Furnizim me diktuna te kembyeseve ne stacionin HRS TERMOKOS-Ritender II me numer te prokurimit TER-22-012-1.2.1

1.Operatori ekonomik duhet te ketë realizuara me sukses , kontrata /Referenca për furnizime te natyrës se ngjashme ne 3 vitet e fundit nga data e njoftimit per kontrate.

Si deshmi eshte kerkuar:

1. Listën e kontratave që specifikon: furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmitë përcjella me certificate tëlivrimit-dorëzimit tëmirë (kopje) ose referencë (kopje), per furnizime ,të nënshkruara nga pranuesi i furnizimeve për kontratat e cekura në listë.

Edhe pse kemi pasur me pak refernca me produkete te natyres se ngjshme ne vitin 20220 ne jemi shperblyer me kete kontrate.

Ndersa ne vitin 2023 per aktivitein e prokurimit *TER-023-024-1.2.1.*– Titulli **Furnizim me diktuna për kembyesin e nxehtesisë 11000 kw** ku kereksa e AK per refence ka qene:

1. **Operatori ekonomik duhet te ketë realizuara me sukses kontrata ne vlere minmale , 55,000.00 € për Furnizime te natyrës se ngjashme ne 3 vitete fundit** Dhe si deshmi ka kerkuar:

   1. Listën e kontratave që specifikon: furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, *duke i bashkëngjitur dëshmitë përcjella me certificate tëlivrimit-dorëzimit tëmirë (kopje) ose referencë (kopje), per furnizime* ,të nënshkruara nga pranuesi i furnizimeve për kontratat e cekura në listë.

Nga sa shihet ne te dy rastet AK ka kerkuar referenca te ngjashme dhe referncat tona te prezentuara ne keto dy kontrta jane identike me keto te prezentuara ne kete dosje te tenderit, dallimi I vetem eshte se ne kete aktivitet kemi prezentuar refenca me shume me produkte prej materiali te gomes se sa ne dy aktivitetet e me hershme.

KJO NENKUPTON SE VLERESIMET SIPAS ZYRTARIT PERGJEGJES TE PROKURIMIT MUND TE BEHEN ME DY STANDARDE, QYSH KUJT I PELQEN DHE NEKUPTON SE NUK KA ASNJE NJE ETIKE PROFESIONALE.

ARSYE TJETER SE AK NE KETE AKTIVITET TE PROKURIMIT NUK KA BERE PUBLIKIMIN NE PERPUTHJE ME DISPOZITAT E LPP-SE DHE KA VENE KRITERE DISKRIMINUESE ESHTE EDHE FAKTI SE FILLIMISHT AK NE KERKESAT E VETA KA KERKUAR SI KUSHT QE OE TE CILET DESHIROJN TE MARRIN PJESE NE KETE AKTIVITET, PERVEQ TJERASH DUHET QE TE PREZENTOJNE EDHE CERTIFIKATEN "CE" PER DIKTUNA.

ME ANKESE NE OSHP, ESHTE KONSTATUAR SE KY KUSHT KA QENE DISKRIMINUES DHE ME VENDIMIN E PANELIT TE OSHP-SE ESHTE KERKUR LARGIMI I KETIJ KRITERI APO KUSHTI. AK E KA LARGUAR KETE KUSHT MIREPO ME KETE VENDIM SHIHET SE KJO DOSJE E TEDNERIT ESHTE PUBLIKUAR PER NDONJE OE TE CILIN AK E KA FAVORIZUAR DHE MEQENSE ME VENDIMN E OSHP-SE ESHTE DASHUR QE TE LARGOHET KY KRITER,

DHE ME HAPJEN E TENDERIT ESHTE VERTETUAR SE OE I FAVORIZUR PER AK NUK E KA OFRUAR CMIMIN ME TE ULET DHE NUK MUND TA SHPERBLEJN ME KONTRATE OE TE TYRE TE FAVORIZUAR, ATEHERE, PATJETER QE DUHET TE GJINDET NJE ARSYE PER ELIMINIM, EDHE PSE KJO ARSYE ESHTE NE KUNDERSHTIM ME DISPOZITAT DHE RREGULLAT E LPP-SE.

PERFUNDIM:

Nga sa u tha me larte, Shihet shume qarte se vendimi I AK eshte diskriminue, tendencioz dhe I pa bazuar ne dispozitat ligjore, dhe mendojm se Zyrtari Pergjegjes I Prokurimit I cili e ka aprovuar vendimin e komisionit per anulim te tenderit dhe per eliminimin tone, eshte pergjegjesi kryesor per keto shkelje flagrante dhe te qellimshme dhe duhet te pergjigejt per veprimet e veta jo ligjore, sepse ky zyrtare ka ditur shume mire se arsyetimi I komisionit te vleresimit eshte I pa bazuar ne dispozitat e LPP-se.

Keshtu qe, **KERKOJM NGA AK**, qe lenden ta kthej ne **RIVLERESIM** dhe te beje vleresimin e ofertes ne perputhje te plote me te gjitha dispozitat dhe rregullat e LPP-se, dhe ne te **SHPERBLEHEMI ME KONTRATE,** meqenese ne kemi ofruar cmimin me te ulet dhe I kemi plotesuar te gjitha kerkesat dhe kushtet e parashtruara ne dosjen e tendertit dhe jemi OE I PERGJEGJSHEM ME CMIMIN ME TE ULET TE OFRUAR.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1	**1.Certifikata e numrit unik te biznesit** **2.Certifikata e TVSH**
	7.2	**1. Certifikata e numrit unik te biznesit** **2.Certifikata e TVSH**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1	*N/A*
	8.2	*N/A*
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1	1.Operatori ekonomik duhet te ketë realizuara me sukses , kontrata në vlere 110,000.00 euro për furnizime te natyrës se ngjashme ne 3 vitet e fundit nga data e njoftimit per kontrate. 2.Garancin nga prodhuesi minim 2 vjeçar për produktin 3.OE duhet të ketë autorizim nga prodhuesi, 4.OE duhet të ketë çertifikaten ISO 9001 5.OE duhet të ofroj garancon 2 vjeçar për produktin, 6.OE duhet të prezantoj katallogun për diktuna
	9.2	1. Listën e kontratave që specifikon: furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmitë përcjella me certificate tëlivrimit-dorëzimit tëmirë (kopje) ose referencë (kopje), per furnizime ,të nënshkruara nga pranuesi i furnizimeve për kontratat e cekura në listë. 2. Garancion per Produktin nga prodhuesi minim 2 vjeçar për produktin. 3. Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi te sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve qe ofroni–origjinal ose i noterizuar 4. OE duhet të ketë çertifikaten ISO 9001 valide 5. OE duhet të ofroj garancon minim 2 Vjeçar për produktin 6. O.E Te prezantoj katallogun me pershkrime teknike per diktuna vetem per artikujt qe jane pjese perberse e DT .
Kriteret e Dhënies	31.1	[Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët];

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i vleresimit te tendereve ka vleresuar te gjitha ofertat dhe konstatojnë:

1.O.E."MULTI SOLUTIONS"SH.P.K. nuk ka plotesuar kerkesat mbi mundesine teknike dhe/ose profesionale te kerkuar ne njoftimin per kontrate dhe dosie te tenderit ;referencat e natyres se ngjajshme dhe katalogun per diktuna me pershkrim teknik.
2.G.O.E. "ZILONIS Kosova GmbH;MG Power Solutions L.L.C. nuk ka plotesuar kerkesat mbi mundesine teknike dhe/ose profesionale te kerkuar ne njoftimin per kontrate dhe dosie te tenderit ;referencat e natyres se ngjajshme ,pas sqarimit te kerkuar ,sqarimet e dhena nga G.O.E. per kete pike te references NUK janë te natyres se ngjajshme gjithashtu referencat e ofruara nuk janë të nënshkruara dhe te vulosura.
3.O.E.BUSINESS PRO"SH.P.K. nuk ka plotesuar kerkesat mbi mundesine teknike dhe/ose profesionale te kerkuar ne njoftimin per kontrate dhe dosie te tenderit ;referencat e natyres se ngjajshme , pas sqarimit te kerkuar ,sqarimet e dhena nga O.E." BUSINESS PRO"SH.P.K. referencat me numer rendor 7,15,16,dhe 20 nuk qendrojne sepse keto referenca nuk janë te natyres se ngjajshme me diktuna per kembyesin e nxetesise as per nga perberja e materialit te gomes dhe as nga funksioni që kryen.
4.O.E."EKSIM COM"SH.P.K. nuk ka plotesuar kerkesat mbi mundesine teknike dhe/ose profesionale te kerkuar ne njoftimin per kontrate dhe dosie te tenderit ;referencat e natyres se ngjajshme ;Autorizimin e prodhuesit ;certifikata ISO dhe sigurinë e tenderit ,andaj komisioni i vleresimit te tenderve rekomandon që të anulohet ky aktivitet i prokurimit pasi që të gjitha ofertat e pranuara janë të pa përgjegjeshme.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit	**Nënshkrimi**
[redacted]	
[redacted]	
[redacted]	

16.11.2023

13

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues eshte pale me interes sipas nenit 4.1.26 te LPP.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **BUSINESS PRO SH.P.K.**

Sqarim Hyrës:

Autoriteti Kontraktues "Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh. A.." ka udhëhequr aktivitetin e Prokurimit: "Furnizim me diktuna të këmbyesit të nxehtësisë me kapacitet teknik 5000KW" me nr. të prokurimit: NP Termoskos.sha-23-7147-1-2-1.

Me datë 12.07.2023 është publikuar njoftimi për kontratë;

Me datë 07.09.2023 Formulari B54 për korrigjimin e gabimeve;

Me datë 29.09.2023 Afati për dorëzimin e ofertave;

Me datë 27.11.2023 Formulari B58 – Njoftimi për vendimin e AK

Me datë 04.12.2023 OE i pakënaqur ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK

Me datë 06.12.2023 AK ka nxjerrë vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e paraqitur nga OE

Me datë 15.12.2023 OE ka paraqitur ankesë pranë OSHP me pretendimet ankimore;

Me datë 22.12.2023 OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues për vlerësimin dhe shqyrtimin e ankesës së OE ankues.

Eksperti shqyrtues sipas autorizimit të datës 22.12.2023 në pajtim me LPP, ka shqyrtuar lëndën dhe pretendimet ankimore të OE ankues.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues në pretendimin ankimor 1 ka paraqitur shkeljen ligjore te bërë nga AK në zvarritjen e procedurës duke i tejkaluar afatet kohore për vlerësimin e ofertave duke potencuar afatet kohore sipas dispozitave ligjore neni 40.3 Rregullores 001/2022 për prokurim Publik.

Përgjigje në pretendimin 1

Pas verifikimit te shkresave te lendes eksperti sqaron se AK në procesin e vlerësimit i ka tejkaluar afatin kohor të përcaktuar sipas rregullores 001/2022, ku sipas nenit 40.3 procesi i vlerësimit duhet të përfundoj brenda aftit kohor 30 ditë nga hapja e ofertave, në raste të jashtëzakonshme mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. AK në këtë rast ka kryer vlerësimin në afatin prej 58 ditësh që është tejkalim i afateve ligjore për 8 ditë.

Tejkalimi i afateve ligjore në vlerësimin e ofertave trajtohet sipas dispozitave të LPP-së dhe nuk paraqet ndikim në vendimin e AK për procedurën në fjalë.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 1 është i bazuar.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues në pretendimin ankimor 2 paraqet shkeljen ligjore të bërë nga AK për vazhdimin e validitetit të ofertave dhe sigurimit të tenderit, në të cilat AK nuk ka bërë kërkesat për zgjatje të afateve sipas dispozitave ligjore.

Përgjigje në pretendimin 2

Eksperti i ka shqyrtuar dokumentet e sigurimit të tenderit dhe konsideron se afatet e sigurimit të tenderit kanë qenë me vlefshme deri me datë 27.12.2023, po ashtu edhe validiteti i ofertave ka qenë 60 ditë nga data e hapjes së ofertave që pas kalkulimit të afateve rezulton se kërkesa e AK për zgjatjen e afatit të validitetit të ofertave dhe sigurimit të tenderit është bërë në datën e skadimit të periudhës së validitetit të ofertave ndërsa sipas nenit 30.4 të RRPP thuhet se AK duhet të bëjë kërkesën me shkrim para datës së skadimit të afatit. Sa i përket sigurimit të tenderit kërkesa është bërë brenda afateve kohore.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 2 është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 3

OE ankues në pretendimin ankimor 3 nuk pajtohet me vlerësimin e AK në lidhje me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale neni 9.1 konkretisht pika1 ofertuesi duhet të ketë të realizuara kontratat dhe referencat për 3 vitet e fundit në vlerën 110,000.00 € për furnizime të natyrës së ngjashme. Ku sipas OE edhe pas sqarimit të dhënë për natyrat e kontratave të realizuara sipas kërkesës së AK, AK prapë nuk i ka marrë parasysh, duke i konsideruar se nuk janë të ngjashme me natyrën e kontratës.

OE në bazë të ankesës pretendon se AK nuk ka vlerësuar drejtë dhe në dosjen e tenderit ka kërkuar kontrata të natyrës së **"ngjashme",** ndërsa në procesin e vlerësimit e ka trajtuar kërkesën të "natyrës së njëjtë" dhe jo të "ngjashme" siç është kërkuar në DT.

Në sqarim të pretendimit OE ankues ka ofruar si dëshmi opinionin e KRPP në lidhje përkufizimin e termave " të njëjtë" apo "të ngjashme" dhe interpretimin e KRPP nr.10 dt.22.11.2022 - në lidhje me "Listen e kontratave te realizuara ne tri vitet e fundit nga data e ublikimit te njoftimit per kontrate ".

Përgjigje në pretendimin 3

Eksperti i ka shqyrtuar dokumentet e ofruara nga OE ankues në lidhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka analizuar ato duke sqaruar se kërkesa e dosjes ka qenë:

Kërkesa:

*1.Operatori ekonomik duhet te ketë realizuara me sukses , kontrata në vlere 110,000.00 euro për furnizime te natyrës se **ngjashme** ne 3 vitet e fundit nga data e njoftimit per kontrate.*

Dëshmitë:

1.Listën e kontratave që specifikon: furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmitë përcjella me certificate të livrimit-dorëzimit të mirë (kopje) ose referencë (kopje), per furnizime, të nënshkruara nga pranuesi i furnizimeve për kontratat e cekura në listë.

Vlerësimi në bazë të kërkesës në dosjen e tenderit është se AK ka kërkuar kontrata për furnizime të "ngjashme" që sipas opinionit të KRPP dallon nga termi e "njëjtë".

Eksperti konsideron se duke u bazuar në LPP neni 69 në lidhje me kapacitete teknike dhe/ose profesionale, paragrafi 2, pika 2.1, OE ankues ka ofruar listën e kontratave sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Në bazë të opinionit të KRPP termi"të njëjta" e definon kërkesën identike me produktin e kontratës, gjë sipas së cilës ka vlerësuar AK, ndërsa termi "të ngjashme" është kur kërkesa paraqet natyrën e ngjashme - që ngjan shumë me produktit të kontratës, por jo identike.

AK në këtë rast e ka vlerësuar kërkesën si "të njëjtë" – identike ndërsa në kërkesën e DT përshkruhet termi e "ngjashme", që do të thotë se ka marrë parasysh termin që nuk është pjesë e dosjes së tenderit duke ndryshuar edhe natyrën e kërkesës në procesin e vlerësimit (gjë e ndaluar sipas LPP neni 59, paragrafi 2).

Shënim: KRPP në opinionin e dhënë ka vlerësuar se si orientim për përcaktim të furnizimeve të ngjashme, AK mund të shërbehen edhe me kodet në FPP.

Në bazë të kodit të përcaktuar FPP (28000000-2) në DT dhe pas verifikimit në e-prokurim tek AK, eksperti ka hasur kod të FPP (28000000-2) dhe ka bërë krahasimet me dokumentet e dosjes. Disa kontrata të cilat AK nuk i ka marrë parasysh në procesin e vlerësimit, janë të natyrës së ngjashme në bazë të kodit FPP 28000000-2 (të udhëhequra nga vetë AK), ku OE ankues i ka të paraqitura në listën e kontratave (kontrata nr.11, 12, 14).

Bazuar në sqarimet e mësipërme dhe opinionin e KRPP, eksperti vlerëson se duhet rivlerësuar lista e kontratave e dorëzuar nga OE në ofertën e tij dhe kontratat e natyrës së ngjashme duhet të merren parasysh, pasi që nuk kufizohen në termin "të njëjta"- identike.

Gjeni të bashkëngjitur Opinionin e KRPP

11. 09.06.2023 Cili është përkufizimi i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme" në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit?

Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme", megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë:

OPINION

Termi "njëjtë (i, e)" mbiemër që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj.

Termi "ngjashëm (i, e)" mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme.

Në kuptim të prokurimit publik:

Termi " njëjtë (i, e)" ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a pune të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës.

Termi "të ngjashme" ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Shembull: Lënda e Kontratës "Furnizim me mollë". Nëse AK kërkon si dëshmi " Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro". Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatoret ekonomik

potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së).

Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përshkruhet si në vijim: "Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara....." Pra, nuk përmendet asnjëri nga termet "të njëjta" apo "të ngjashme".

Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t'i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para.

Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në këtë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 3 është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **BUSINESS PRO SH.P.K.**

Enver Bytyçi